

ÇOHU!

Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjitet, Çohu!



VEPRIMI KUNDREJT PERFORMIMIT

KONFISKIMI I PASURISË NË KOSOVË

MARS, 2016



ÇOHU!

Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjitet, Çohu!



VEPRIMI KUNDREJT PERFORMIMIT

KONFISKIMI I PASURISË NË KOSOVË

MARS, 2016



Kjo analizë është mundësuar me mbështetje të
CRD-Civil Rights Defenders dhe KFOS-Fondacioni i
Kosovës për Shoqëri të Hapur



Deklaratë mohimi:

Përmbajtja e kësaj analize është përgjegjësi e
plotë e Organizatës Çohu!, dhe rrjedhimisht nuk
reflekton qëndrimet e donatorëve të projektit.

Autorë:

Altin Ademi dhe Arton Demhasaj

Lekturoi:

Besa Kalaja

Origjinali është shkruar në shqip

Publikuar nga:

Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe
Dinjitet, Çohu!
Rruga: Rrustem Statovci Nr.17; Prishtinë, Kosova
Tel / +381 (0)38 248 506
www.cohu.org



PËRMB

0 ⁰⁸

**Përmbledhje
Ekzekutive**

Metodologjia

1 ¹²

**Vendosja e
Kontekstit**

**1.1 Metodologjia
1.1 Standardet
bashkëkohore**

2 ¹⁸

**Konfiskimi i
aseteve në
Kosovë**

**2.1 Statistikat e
Sekuestrimit
dhe Konfiskimit
të Pasurisë
në Kosovë
– Të dhënat
kontradiktore**

AJTJA



3

32

Konfiskimi i pasurisë në legjislacionin dhe praktikën rajonale

3.1 Përmbajtja e legjislacionit mbi konfiskimin e pasurisë në vendet e rajonit

3.1.1 Shqipëria

3.1.2 Serbia

3.1.3 Rumania

4

36

Një perspektivë krahasuese ligjore për konfiskimin e pasurisë në Kosovë

5

40

Rekomandimet themelore

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në temat që renditen si pjesë e politikave për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, konfiskimi i pasurisë së përfituar në mënyrë të paligjshme paraqet një ndër sfidat më të rëndësishme, për shkak se konfiskimi si koncept, është para së gjithash një veprimtari praktike që dëshmon gatishmërinë e institucioneve përgjegjëse për të luftuar krimin e organizuar dhe paralelisht me këtë, për të siguruar qytetarët se asetet e përfituara në mënyrë joligjore nuk do të përdoren për të shtuar nivelin e krimit të organizuar.

Republika e Kosovës është në proces të hartimit të legjislacionit që rregullon fushën e konfiskimit të pasurisë, si një nevojë e përditshmërisë shoqërore dhe si një obligim për të avancuar agjendën e shtet-ndërtimit institucional në kuadër të integrimeve evropiane.

Megjithatë, duke pasur parasysh diskursin përmes së cilit është shtruar debati institucional në këtë drejtim, konsiderojmë se është e nevojshme që konfiskimi i pasurisë si kategori ligjore dhe si strukturë menaxhimi, të shtrohet nga një perspektivë më e gjerë, në mënyrë që i njëjti të korrespondojë me një sistem të mirëfilltë që i përgjigjet nevojave reale dhe karakteristikave socio-politiko-ekonomike e institucionale të vendit.

Në këtë rrjedhë, është me rëndësi që të analizohen propozimet mbi ndryshimin e legjislacionit aktual duke u bazuar mbi përvojën e deritanishme, në mënyrë që të

“

Ky studim/analizë, është i ndërtuar mbi bazën e interpretimit të të dhënave mbi konfiskimin e pasurisë, mbi praktikat më të mira rajonale dhe ndërkombëtare të konfiskimit të pasurisë, dhe mbi analizën e përmbajtjes së legjislacionit aktual që rregullon këtë fushë.

maten efektet e tij, duke ofruar kështu një pikëpamje më të gjerë rreth ndryshimeve të duhura ligjore që të korrespondojnë me një vlerësim paraprak mbi atë se si ka shkuar ky proces në të kaluarën dhe cilat janë përvojat më të mira për të adresuar boshllëqet të cilat janë hasur.

Ky studim/analizë, është i ndërtuar mbi bazën e interpretimit të të dhënave mbi konfiskimin e pasurisë, mbi praktikat më të mira rajonale dhe ndërkombëtare të konfiskimit të pasurisë, dhe mbi analizën e përmbajtjes së legjislacionit aktual që rregullon këtë fushë.

Ideja themelore prapa këtij studimi ka pasur për qëllim që të ofrojë një interpretim autentik mbi atë se cili është formati legal i konfiskimit të pasurisë në Kosovë dhe çfarë do të duhej të ndryshonte në këtë proces. Kjo ide i ka paraprirë edhe vetë qëllimit të studimit, i cili është ndërtuar si një shëmbëlltje se si do të mund të sfidohet dhe atakohet financimi i aktiviteteve kriminale përmes të hyrave të siguruara nga asetet e përfituara në mënyrë të paligjshme.

Për të ndërtuar një përfytyrim mbi konceptin e konfiskimit të pasurisë, gjatë fazës së hartimit të këtij studimi, janë përzgjedhur dhe krahasuar disa modele të legjislacionit dhe të praktikave mbi konfiskimin e pasurisë, siç janë shembujt nga Shqipëria, Serbia, Rumania etj, përfshirë edhe bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë drejtim.

METODOLOGJIA

Hartimi i këtij studimi dhe procedura shkencore për të ndërtuar variabla të matshme në sjelljen e një diskursi të ri argumentues dhe analitik mbi çështjen e konfiskimit të pasurisë, ka qenë dhe është një nevojë aktuale. Bazuar në këto parametra, organizata Çohu! ka ndërmarrë këtë studim për të thelluar edhe më tej, kryesisht në përmbajtje, kontributin për procesin e konfiskimit të pasurisë, bazuar në një metodologji të kombinuar.

Baza e përcaktuar si pikënisje për ndërtimin e analizës ka qenë **shqyrtimi i standardeve ndërkombëtare** të konfiskimit të pasurisë, për t'i sjellë dhe analizuar ato në kontekstin e Kosovës. Mëtuqje, është shqyrtuar **legjislacioni dhe praktika** aktuale e konfiskimit të pasurisë si dhe janë dhënë disa statistika në funksion të vlerësimit të shkallës së implementimit të legjislacionit. Si pararendëse të këtyre analizave, kanë qenë edhe vizitat në institucionet përkatëse dhe **intervistat** me akterët e përfshirë në fushën e konfiskimit të pasurisë.



01

VENDOSJA E KONTEKSTIT

1.1 DEFINIMI I ÇËSHTJES

Shtetet bashkëkohore kanë vendosur imperativ të nivelit të lartë që të sigurohen që kryesve të veprave penale, përkatësisht krimin të organizuar, t'iu pamundësohet përfitimi nga aktiviteti i tyre kriminal.

Shumë vende dhe sisteme juridike kanë përpiluar legjislation të përshtatshëm dhe të organizuar mirë për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë, si dhe vendosjen e praktikave gjyqësore të nevojshme për t'i shërbyer kësaj agjende.

Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve dhe tendencave për të ndërtuar standarde unike, diversiteti socio-kulturor dhe varietetet institucionale dallojnë nga një vend në tjetrin qoftë nga formati ashtu edhe nga shtrirja e fuqisë, gjë që e ka bërë të pamundur ekzistencën e unifikuar të këtyre standardeve. Kjo megjithatë nuk do të thotë që nuk ka parime unike dhe të cilat vlejné ndërkombëtarisht sa i përket konfiskimit të pasurisë. Madje përpjekjet për të përsëritur “storie suksesi” nga një vend në tjetrin janë në trend të rritjes dhe se debati mbi atë se çfarë është vlerë universale qoftë në kuptimin ligjor ashtu edhe në atë praktik vazhdon të provokojë ligjvënësit në shumë vende të botës. Ky debat shpesh herë merr formë konkrete dhe ngrihet mbi çështjet e ndryshme parë nga perspektiva globale. Ndër temat që zënë vend shpesh në diskursin e ligjvënësve sa i përket çështjes së konfiskimit të pasurisë në shkallë globale ndër më të theksuarat figurojnë të jenë:

- a) Tendenca në rritje për të konsoliduar ekipe speciale për hetimin e pasurisë së paligjshme që është përfituar me vepra kriminale;
- b) Procedurat e rikuperimit të pasurive të konfiskuara kundrejt shkeljes së të drejtave të njeriut;
- c) Menaxhimi i vlerës dhe ruajtja e vlerës së pasurisë së konfiskuar;
- d) Bashkëpunimi ndërkombëtar; etj.

Këto debate janë lehtë të definuara edhe në Kosovë. Duke filluar nga tema e trupave institucional që janë të parapara të implementojnë fushëveprimin mbi konfiskimin e pasurisë, pastaj natyrën e procedurave të parapara për të përfunduar një proces të tillë e deri tek menaxhimi i pasurisë së konfiskuar, janë shtylla në të cilat ka mungesa të theksuara të cilat do të jenë subjekt i këtij trajtimi.

Në rrafshin e bashkëpunimit ndërkombëtar, megjithëse Republika e Kosovës është në proces të konsolidimit, ende ka nevojë të rrisë kapacitetet institucionale, ndonëse aktualisht institucionet përkatëse janë pjesë e rrjetit CARIN, që shërben në mos për ndonjë efekt tjetër të drejtpërdrejtë, për shkëmbim informatash. Por më e rëndësishme dhe e domosdoshme është të analizohet niveli i bashkëpunimit të brendshëm ndër-sektorial, për shkak se konfiskimi i pasurisë dhe rikthimi i pasurisë së fituar me vepër penale kërkon bashkëpunim dhe koordinim ndër-disciplinar të strukturave të sundimit të rendit dhe ligjit, autoriteteve tatimore, doganave, autoriteteve të kontrollit financiar etj. Ky bashkëpunim kërkohet në radhë të parë jo vetëm për të vepruar kundër krimin të organizuar por edhe për ta parandaluar atë, prandaj institucionet që operojnë me informacione, që menaxhojnë aktivitetet rreth sigurisë dhe ato që janë të specializuara për luftimin e krimin duhet të kenë një qasje të përbashkët ndër-sektoriale.

Në përgjithësi, megjithëse janë vendosur bazat për një sistem veprimi, ende nuk janë definuar mirë vlerat të cilat e karakterizojnë konfiskimin e pasurisë në Kosovë. Me fjalë të tjera, paqartësitë lëvizin që nga konteksti i kuptimit të legjislationit në fuqi, e deri tek paqartësitë mes asaj se çfarë përfaqëson konfiskimi si tërësi, dhe çfarë përfaqësojnë apo se deri ku shtrihen pjesët përbërëse të këtij procesi, siç janë ngrirja dhe sekuestrimi i asetëve.

Tradita legjislativë mbi konfiskimin, siç do të shohim më tutje, sipas formatit të tillë çfarë ka qenë, nuk është dëshmuar e mjaftueshme për të ndërtuar një “agjendë” shtetërore për këtë problem që adresohet këtu. Ka mungesë të theksuar të debatit përmbytësor rreth asaj se

kujt i adresohet konfiskimi dhe nëse i njëjti përkon me karakteristikat socio-kulturore të vendit. Pra nuk janë të qarta tendencat e orientimit të sistemit drejt një përfshirje të përgjithshme bazuar në parimin “Ligji për të gjithë” apo nëse synohet të ndërtohet një sistem “Kleptokrat” që për subjekt ka kryesisht sektorin publik dhe bartësit e pozitive të larta menaxhuese në të.

Duke pasur për bazë konstatimet e mësipërme, Çohu! ka paraparë që një pjesë e këtyre çështjeve të shtrohen përmes kësaj analize dhe të njëjtat të shërbejnë në procesin e rishikimit të legjislacionit në fuqi. Mbi këtë kontekst, duke u nisur nga përsiatjet teorike dhe nga matja e realitetit institucional, studimi është i ndërtuar me tendencë për të ofruar përgjigje dhe alternativa për së paku disa nga debatet që i përkasin kësaj fushe, siç janë dhënë në vijim:

- A është konfiskimi i pasurisë, një prioritet në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit në Republikën e Kosovës?

- Cilat janë statistikat e konfiskimit të pasurisë, ngrirjes dhe sekuestrimit të saj dhe çfarë indikatori janë ato për të matur shkallën e implementimit të ligjeve në fuqi?

- A ka qenë Ligji për Kompetencat e Zgjeruara një zgjidhje e menduar mirë dhe çfarë formati përmbytësor duhet të ketë një ligj i ri që rregullon këtë fushë?

- A janë gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë të përgatitur për të implementuar politikën shtetërore të konfiskimit të pasurisë?

“

Shumë vende dhe sisteme juridike kanë përpiluar legjislacion të përshtatshëm dhe të organizuar mirë për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë, si dhe vendosjen e praktikave gjyqësore të nevojshme për t’i shërbyer kësaj agjende.

1.2 STANDARDET BASHKËKOHORE

Në kuptimin institucional, ligjor dhe politik, konfiskimi i pasurisë është një element që zë vend në legjislacionet përkatëse të shteteve bashkëkohore, ndërsa në nivelin ndërkombëtar pavarësisht përpjekjeve për të unifikuar karakterin e politikave mbi konfiskimin, ende nuk mund të thuhet se ekziston një metodologji unike dhe e standardizuar si nga aspekti i procedurave ligjore, ashtu edhe për nga struktura përmbajtësore e natyrës së ligjeve. Megjithatë, nëse duhet theksuar atë çfarë paraqet konfiskimin si një standard ndërkombëtar, pikënisje dhe një bazë e mirë duhet të referohet Konventa Kundër Korrupsionit e Kombeve të Bashkuara (**United Nations, Office on Drugs and Crime, 2004**)

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit i ka dhënë nxitje të madhe lindjes së shumë mekanizmave ligjor e institucional që adresojnë çështjen e konfiskimit të pasurisë. Pikat 1 deri në 6 të Nenit 52 të Konventës, afirmojnë dhe kërkojnë një kontroll të mirë financiar, një sistem të mirë të deklarimit si pararendëse e identifikimit të pasurive të fituara jashtëligjshëm, ndërsa neni 54 i saj, hapë rrugë për ndërtimin e mekanizmave që do të duhej të krijonin shtetet, në mënyrë që kjo politikë të implementohej si duhet.

Në kontekstin e Bashkimit Evropian, ka pasur disa rregullore dhe direktiva që kanë avancuar gradualisht politikën mbi konfiskimin e pasurisë. Që nga nisma për veprim të përbashkët e vitit 1998 (Akti 98/699 JHA), kundër pastrimit të parave, identifikimit, ngrirjes dhe konfiskimit të aseteve të përfituara përmes krimit, Bashkimi Evropian ka nxjerrë vazhdimisht një numër direktivash që kishin për synim avancimin e kësaj agjende dhe mobilizimin e shteteve anëtare për të vendosur standarde në luftën kundër krimit të organizuar, mëqenëse në procesin e konfiskimit të pasurisë. Kështu në vitin 2001, BE miratoi Vendimin Kornizë të Këshillit për Shpëlarjen e Parave, Identifikimin, Hetimin, Ngrirjen dhe Konfiskimin e Pa-

surive të fituara nga Krimi,² një akt që kishte për qëllim nxitjen e shteteve anëtare për implementimin e mëtejme të Konventës së BE-së së vitit 1990 mbi po të njëjtën temë. Në vitin 2005, pas një analize që kishte bërë rreth implementimit të direktivave të deriatëhershme, dhe duke konsideruar që sektorë të caktuar të krimit të organizuar (siç ishte trafikimi me emigrantë) vazhdonin të mbeteshin në fuqi, me 24 shkurt, 2005, Këshilli Evropian miratoi Aktin 2005/212/JHA, mbi Konfiskimin e Pasurisë së përfituar përmes krimit dhe e avancoi më tutje diskursin, veçanërisht duke i dhënë karakter të plotë penal. Përmes këtij akti, BE vendosi disa standarde të definuara mirë mbi atë se kur një konfiskim duhet të zë vend.³ Mirëpo, përveç kësaj, një veçori e këtij akti ligjor ishte edhe alternativa e ofruar që shtetet anëtare mund të përdorin edhe masa të tjera ligjore jo domosdoshmërisht të karakterit penal. Akte të tjera të rëndësishme të BE-së në fushën e konfiskimit të pasurisë mund të konsiderohen edhe Vendimi për Njohjen Reciproke të Urdhëresave për Konfiskim nga shtetet anëtare (2006/783/JHA), pastaj ai për Koordinimin dhe Bashkëpunimin në mes Zyrave të Konfiskimit të shteteve anëtare dhe atyre që janë pjesë e rrjetit CARIN (2007-845 JHA).

Në vitin 2014, Parlamenti Evropian ka miratuar Direktivën 2014/42/EU⁴ e cila përmbledh përkushtimin e Bashkimit Evropian për të shndërruar çështjen e konfiskimit të pasurisë në një prioritet më të madh dhe me kërkesa për të arritur rezultate konkrete në këtë drejtim. Në këtë direktivë, është me rëndësi të theksohet se disa aspekte që lidhen me konfiskimin, sërish u atribuohen në përgjegjësi shteteve anëtare.

Mëqenëse siç mund të shihet, konfiskimi i pasurisë nuk mund të përkufizohet me një standard unik por nga një numër sistemesh përafërsisht të ngjashme dhe me

1 Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, Kapitulli V, Rikthimi i Pasurisë, Nenit 51-59, fq 42-48, https://www.unodc.org/documents/brussels/UN_Convention_Against_Corruption.pdf ;

2 Official Journal of European Union, Act 2001/500/JHA, dt.05.07.2001, L 182/1, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32001F0500:EN:HTML>;

3 Official Journal of European Union, Act 2005/212/JHA, dt. 15.03.2005, L 68/49, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2005:068:0049:0051:en:PDF>;

4 Official Journal of European Union, Directive 2014/42/Eu, 29.04.2014, L 127/39, <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32014L0042>;

tendenca drejt unifikimit, është me rëndësi të vihen në dukje disa nga modelet më të aplikuara të konfiskimit të pasurisë dhe që në përgjithësi përfshihen në tre modele:

- 1) Konfiskimi me bazë penale;
- 2) Konfiskimi Miks (një kombinim i modelit civil dhe penal i cili inicohet në mënyrë administrative nga prokurorët duke pasur për bazë indikacione siç janë për shembull deklarimi i pasurisë etj.;
- 3) Konfiskimi si rrjedhojë e aksionit qytetar (civil);

Këto modele aplikohen me masa të ndryshme, varësisht nga formati legjislativ, por përgjithësisht disa nga veprimet që dalin nga to, përfshijnë veprimet si:

- a) Urdhrat nga gjykatat apo trupat tjerë shtetëror për ngrirjen e drejtpërdrejtë apo konfiskimin e pasurisë;
- b) Konfiskimi i pasurisë bazuar jo domosdoshmërisht në dënim penal, veçanërisht në rastet e vdekjes, apo mungesës së kryesit;
- c) Konfiskimi i pasurisë me prejardhje të huaj, duke argumentuar veprën e pastrimit të parave;
- d) Urdhëresat e gjykatave për kompensimin e dëmit apo njohjes së pronësisë së një pale kundrejt një pale tjetër, pasi që është konstatuar se pala ka qenë përfituese e pasurisë përmes korrupsionit;
- e) Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe kthimi i aseteve; etj.⁵

Varësisht nga modeli dhe rregullimi ligjor për konfiskimin e pasurisë, ekzistojnë edhe procedurat përkatëse dhe metodologji juridike. Nëse shihen në mënyrë të përgjithësuar, këto procedura ligjore pasohen nga disa hapa, të cilat kryesisht nënkuptojnë:⁶

- a) Mbledhjen e informatave, provave dhe ndjekjen e aseteve;
- b) Sigurimi i aseteve;
- c) Shqyrtimi gjyqësor;
- d) Zbatimi i vendimeve gjyqësore; dhe
- e) Kthimi i aseteve;

Në përgjithësi, nëse analizohet baza ligjore dhe politika institucionale që lidhet me konfiskimin e pasurisë, del që trendi në nivel ndërkombëtar rreth vendosjes së parimeve dhe standardeve unike, kryesisht gjeneron dhe avokon rreth parimeve si në vijim:⁷

- 1) Ndërtimi i modeleve të konfiskimit që i përgjigjen karakteristikave konkrete të vendeve;
- 2) Ndërtimi i trupave të specializuar që e implementojnë sistemin e konfiskimit;
- 3) Garancia që në të gjithë hapat do të ketë respektim të të drejtave të njeriut;
- 4) Sigurimi që konfiskimi i pasurisë të jetë rezultat vetëm atëherë kur lëshohet një urdhër gjykate, qoftë në procedurë penale, qoftë në procedurë civile; etj.

Më tutje në këtë analizë, do të interpretojmë realitetin kontekstual në Kosovë mbi prizmin e këtyre standardeve të sipërpërmendura, për të parë shkallën e vetëdijes institucionale të zhvilluar deri më tani në këtë drejtim dhe për të kuptuar mënyrën se si funksionon sistemi i konfiskimit të pasurisë në Kosovë, krahasuar me këto parime dhe standarde të aplikuara ndërkombëtarisht.

5 J.P. Brun, L. Gray, C. Scott, K.M. Stephenson "Asset Recovery Handbook: A guide for Practitioners" World Bank, STAR, 2011, fq 1;

6 Po aty, fq. 6;

7 Transparency International, Bulgaria, Rumania, Italy, "Confiscation of Criminal and Illegal Assets: European Perspectives in Combat Against Serious Crime" Policy Paper available at: http://www.confiscation.eu/site/wp-content/uploads/2015/03/Policy_Paper_EN_ëeb.pdf



02

**KONFISKIMI
I ASETËVE NË
KOSOVË**

Kosova është një shtet i ri dhe në konsolidim e sipër. Historiku i procesit të konfiskimit të pasurisë në Kosovë megjithatë është më i hershëm sesa vetë shpallja e shtetësisë së saj. Dispozitat ligjore në Kosovë për konfiskimin e pasurisë, pas luftës dhe vendosjes së administrimit ndërkombëtar janë përcaktuar fillimisht me Kodin Penal të vitit 2004.⁸ Po ashtu, një bazë juridike për konfiskim të pasurisë ka ekzistuar edhe në periudhat e mëhershme gjatë administrimit të Kosovës nga sistemi juridik i ish Jugosllavisë.

Megjithatë, dispozitat për konfiskim përafërsisht çfarë janë sot në fuqi e të cilat kanë qenë që nga viti 2004 në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale, nuk kanë treguar sukses në luftimin e pasurimit të paligjshëm, për çka, është mëse e nevojshme që të hartohet një legjislacion i ri, i cili në fakt duhet të ndryshojë edhe shumë aspekte themelore të natyrshmërisë juridike më shumë sesa që të fokusohet në vetë strukturën e procesit të konfiskimit të pasurisë.

Pararendëse e konkluzionit për nevojën e një legjislacioni të ri dhe një fryme të re që është e nevojshme në Kosovë sa i përket çështjes së konfiskimit të pasurisë, është analiza e legjislacionit aktual dhe atij të kaluar, përgjatë trajektorës së evoluimit të tyre dhe rezultateve të arritura përgjatë implementimit të tyre. Baza kryesore e konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale në të kaluarën ka qenë Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, për t'u plotësuar më pas edhe me Ligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurive të fituara me vepër penale. Në një vështrim kritik dhe analitik të këtyre shtyllave ligjore, vërehen disa deficite të rëndësishme që ne i kemi shqyrtuar dhe të cilat janë dhënë në vijim:

a) Në Kodin Penal nuk përmendet fare ngrirja e pasurisë, por vetëm konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale. Ngrirjen e pasurisë e parasheh vetëm Kodi i Procedurës Penale në nenin 264, ku thuhet se asetet mund të ngrihen nëse: “pasuria është përdorur në veprën penale në hetim, - është provë e veprës penale në hetim, - është fituar nga vepra penale në hetim”. Kësisoj, na paraqitet një paradoks i vërtetë se si mund të parashihet me Kodin e Procedurës Penale, procedura e ngrirjes së

përkohshme të aseteve, ndërsa me Kod Penal i cili duhet të bëjë kodifikimin e secilës vepër penale, rrjedhimisht edhe atë të konfiskimit të aseteve, nuk e përmend fare as ngrirjen dhe as sekuestrimin e aseteve. Kjo nënkupton se legjislacioni i ynë penal nuk e njuh, (ose e njuh pjesërisht), institucionin juridik të ngrirjes së pasurisë, por vetëm atë të konfiskimit të pasurisë dhe këtë vetëm pas nxjerrjes së një vendimi gjyqësor me të cilin i dyshuari dënohet për një vepër penale. Pas dënimit për vepër penale atëherë prokurori i çështjes mundet brenda 30 ditësh të nisë kërkesën e bazuar për shqyrtimin e pasurisë së dyshimtë që mund ta posedojë i dënuari për vepër penale. Kjo nënkupton se nuk mund të hetohet, ngrihet ose konfiskohet pasuria e askujt derisa nuk kemi një shqiptim të dënimit për një vepër penale nga një panel gjyqësor;

b) Në Kodin Penal shprehimisht thuhet se:⁹ “*askush nuk mund ta mbajë dobinë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale, dobia pasurore e fituar me vepër penale konfiskohet me aktgjykim të gjykatës me të cilin është konstatuar kryerja e veprës penale*”. Kjo nënkupton se në parim baza ligjore për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale ekziston në Kodin Penal. Mirëpo kjo bazë ligjore së bashku edhe me Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara merren vetëm me konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale, me ç'rast përjashton shprehimisht çdo konfiskim të pasurisë për të cilën ekzistojnë fakte që derivon nga veprimtaria kriminale, ndonëse e njëjta nuk ka qenë subjekt i hetimit dhe vendimeve gjyqësore. Kjo e sjell edhe debatin mbi nevojën për të pasur një Ligj të ri që e avancojnë agjendën e konfiskimit përtej lidhshmërisë së ngushtë me vepër penale;

c) Në legjislacionin në fuqi, aktualisht barra e provës rreth vërtetimit të prejardhjes së pasurisë nëse është fituar në mënyrë të paligjshme ose jo (me anë të veprës penale), i bie përgjithësisht prokurorisë, për çfarë rezultatet e pritshme e vënë theksin tek aftësia e prokurorëve për të nxjerrë dëshmitë e nevojshme mbi një vepër penale, dhe rrjedhimisht edhe tek performanca e tyre si indikator i shkallës së luftimit të kimit të organizuar dhe konfiskimit të pasurisë së

8 Rregullorja nr. 2003/25, Gazeta Zyrtare, 6 Korrik 2003, Kodi Penal i Kosovës, Kapitulli VII, Nenet 82-85, http://gazetajnk.com/repository/docs/RA2003_25_CCintranet_295748.pdf;

9 Kodi nr. 04/L-082: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 96, <http://www.kuvend-ikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf>;

përfitur me vepra penale. Nga kjo infrastrukturë ligjore, përjashtohet mundësia e konfiskimit të pasurisë së përfitur me veprën penale në momentin kur prokurori dështon të mbledhë faktet dhe provat e mjaftueshme për lidhjen e asaj pasurie me aktivitetin kriminal, dhe rrjedhimisht të hapësirë për sofistikimin e akterëve të krimit të organizuar për të mbuluar dhe shkëputur pasurinë e tyre nga aktiviteti i tyre kriminal. Një debat për alternativat tjera mbi barrën e provës është jashtëzakonisht i nevojshëm dhe stimulon një luftim më efikas të këtyre dukurive;¹⁰

- d) Mënyra e konfiskimit të pasurisë së fituar me anë të kryerjes së veprave penale sipas metodologjisë së përcaktuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës është si vijon: Kryesit i konfiskohet dobia pasurore ndërsa në rastet kur konfiskimi nuk është i mundshëm, kryesit i detyrohet të paguajë shumën e të hollave e cila i përgjigjet dobisë së fituar pasurore.¹¹ Ngjashëm me këtë rregullohet edhe me Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Vepër Penale. Përjashtimisht me këtë ligj jepet edhe e drejta e nisjes së procedurës së konfiskimit të dobisë pasurore nga prokurori i rastit, mirëpo duhet fillimisht që të ketë një aktgjykim dënues për të dyshuarin. **Pasuria mund të konfiskohet edhe nëse nuk ka ndërlidhje me veprën që dënohet, mirëpo në rrethana të ngjashme ose kur nuk mund të justifikohet pasuria e poseduar.** Mirëpo për të gjithë këto prokurori duhet të bëjë një kërkesë të bazuar, përndryshe kërkesa hidhet poshtë nga trupi gjyqësor.¹² Kodi i Procedurës Penale për dallim nga Kodi Penal dhe Ligji për Kom-

petencat e Zgjeruara për konfiskimin e pasurive të fituara me vepër penale, pos konfiskimit ka paraparë edhe procedura të ngrirjes së përkohshme të aseteve, dhe procedura të sekuestrimit të aseteve. Nga të tre këto mekanizma, gjatë periudhës së deritanishme rastet e kualifikuara për ngrirje të pasurisë nuk janë materializuar për shkaqe të ndryshme. Sipas këndvështrimit juridik, në rastet siç kanë qenë ai i Natali Veliajt, Klinikës Medicus, pastaj rasteve të dyshuara për korrupsion ku përfshiheshin zyrtarët e lartë të dikasterëve qeveritare siç është Ministria e Transportit etj. nuk janë zbatuar masat e ngrirjes së pasurisë.¹³ Shkaqet për shtangimin e procedurës së ngrirjes së pasurisë nuk janë shumë të qarta, por përgjithësisht kjo i atribuohet mungesës së urdhëresave të drejtpërdrejta gjyqësore për ngrirje të aseteve. Sipas Kodit Penal, çdo ndërtesë, pasuri e paluajtshme, pasuri e luajtshme ose aset për të cilin prokurori i shtetit ka prova të artikuluar që tregojnë dyshim të bazuar se:

- a) ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset është përdorur në veprën penale nën hetim;
- b) ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset është provë e veprës penale nën hetim; ose
- c) ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset është fituar nga vepra penale nën hetim. Çfarëdo llogarie financiare që i takon të pandehurit nën hetim, në të cilën mund të ketë mjete të cilat janë: të ardhura nga vepra penale nën hetim; ose, të përdorura në kryerjen e vazhdueshme të veprës penale nën hetim.¹⁴

10 Këto modele janë të njohura, siç mund të merret rasti me disa vende të rajonit p.sh. Republika e Shqipërisë, Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë neni 21 pika 3 thotë: "Barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi". (Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë i R. Shqipërisë neni 24 pika 2 thotë: Gjykata mund të vendosë pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë edhe kur:

- a) procedimi penal i filluar ndaj personit pushohet nga organi procedues për shkak:
 - i) të pamjaftueshmërisë së provave;
 - ii) të vdekjes së personit;
- iii) se personi nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet;
- b) personi deklarohet i pafajshëm penalisht për shkak:
 - i) të pamjaftueshmërisë së provave;
 - ii) se vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet;
- c) personi është proceduar për një veprë penale, që përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji, por gjatë procedimit penal ndryshohet cilësimi juridik i veprës dhe vepra e re është jashtë fushës së zbatimit të këtij ligji.)

11 **Kodi Penal i Republikës së Kosovës**, neni 97, <http://www.kuvend-ikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf>

12 Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale, neni 6.

13 Portali Telegrafi: <http://www.telegrafi.com/lajme/deshtojne-urdheresat-per-ngrirje-dhe-konfiskim-pasurie-2-56172.html>

14 Kodi i Procedurës Penale: Neni 264 Ngrirja e përkohshme e aseteve, http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Kodi_i_procedures_penale.pdf;

1. Nëse hetimi është autorizuar për vepër penale nga neni 90 i këtij Kodi, prokurori i shtetit mund të lëshojë urdhër për ndalimin e shijes, shkëmbimit të pronësisë ose tërheqjen nga llogaria të cillitdo send të përkohshëm në paragrafin 2 ose 3. të këtij neni.
2. Çdo ndërtesë, pasuri e paluajtshme, pasuri e luajtshme ose aset për të cilin prokurori i shtetit ka prova të artikulueshme që tregojnë dyshim të bazuar se:
 - 2.1. ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset është përdorur në veprën penale nën hetim;
 - 2.2. ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset është provë e veprës penale nën hetim; ose
 - 2.3. ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset është fituar nga vepra penale nën hetim.
3. Çfarëdo llogarie financiare që i takon të pandehurit nën hetim, në të cilën mund të ketë mjete të cilat janë:

Pra siç mund të shihet, të tria shtyllat legjislative që rregullojnë çështjen e konfiskimit të pasurisë në Kosovë, kanë diskrepancë në mes vete dhe rrjedhimisht shkaktojnë konfuzion për të kuptuar fytyrën e përgjithshme të sistemit. Si rezultat i kësaj diskrepance ka mungesë të identifikimit të mirëfilltë se kur është duke operuar logjika e Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale apo Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara. Për një efekt të tillë janë shtruar edhe debate institucionale. Qeveria e Kosovës, gjegjësisht Ministria e Drejtësisë, për një kohë

- 3.1. të ardhura nga vepra penale nën hetim; ose
- 3.2. përdorur në kryerjen e vazhdueshme të veprës penale nën hetim.
4. Urdhri i prokurorit të shtetit nga ky nen ka efektin e mëposhtëm:
 - 4.1. çdo bankë apo institucion financiar që pranon urdhrin nga ky nen menjëherë ndalon çfarëdo aktiviteti të mëtejme të llogarisë bankare të përshkruar në urdhrë. Banka nuk është përgjegjëse ndaj mbajtësit të llogarisë bankare për veprimet e saj në pajtim me urdhrin nga ky paragraf.
 - 4.2. cilado palë tjetër që pranon urdhrin nga ky nen duhet të ndërmerr hapat e arsyeshëm për t'iu bindur urdhrit.
5. Urdhri i prokurorit të shtetit nga ky nen mund të lëshohet vetëm një herë dhe është i vlefshëm vetëm për shtatëdhjetë e dy (72) orë nga koha e lëshimit të urdhrit.
6. Në urdhrin e prokurorit të shtetit përshkruhet ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme, llogaria financiare ose aset dhe i urdhëron pranuesit të urdhrit që të ndalojë shitjen, shkëmbimin e pronësisë ose tërheqjen nga llogaria për shtatëdhjetë e dy (72) orë nga koha e lëshimit të urdhrit. Në urdhrë ceket koha e lëshimit dhe koha e skadimit të urdhrit.
7. Urdhri nga ky paragraf mund të lëshohet nga prokurori i shtetit nëse ai i paraqet kërkesë gjyqtarit të procedurës paraprake për urdhrë ndalues nga neni 265 i këtij Kodi për asetin e përcaktuar në urdhrë.

Neni 265 Urdhri ndalues 1. Prokurori i shtetit i cili lëshon urdhrin për ngrirjen e përkohshme të aseteve nga neni 264 i këtij Kodi menjëherë i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesë për urdhrë ndalues për asetin e përcaktuar në urdhrin për ngrirjen e përkohshme të asetit.

2. Kërkesa për urdhrë ndalues përmban:
 - 2.1. kopjen e urdhrit për ngrirjen e përkohshme të aseteve;
 - 2.2. përshkrimin e provave të artikuleshme që arsyetojnë urdhrin;
 - 2.3. përshkrimin e arsyeve që urdhrin ndalues të ndalojë shitjen, shkëmbimin apo tërheqjen nga llogaria e asetit të përshkruar; dhe
 - 2.4. identitetin e të gjithë personave që kanë interes pasuror në asetin e përshkruar, siç përcaktohet në regjistrat kadastral apo regjistrat tjerë qeveritar.
3. Gjyqtari i procedurës paraprake lëshon urdhrë ndalues për secilin aset që kërkohet nëse prokurori i shtetit me anë të provave të artikuleshme tregon shkak të bazuar për të arsyetuar urdhrin.
4. Gjyqtari i procedurës paraprake refuzon ose lëshon urdhrin ndalues para skadimit të urdhrit për ngrirjen e përkohshme të aseteve.
5. Urdhri ndalues i lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprak në Kosovë vlen për të gjithë territorin e Kosovës.
6. Urdhri ndalues përcakton ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme, llogarinë financiare apo asetin dhe urdhëron pranuesin e urdhrit që të ndalojë shitjen, shkëmbimin e pronësisë ose tërheqjen nga llogaria për tridhjetë (30) ditë nga koha e lëshimit të urdhrit. Në urdhrë ceket koha e lëshimit dhe koha e skadimit të urdhrit.
7. Urdhri i dërgohet institucionit financiar ose palës tjetër për të cilën është lëshuar urdhri për ngrirjen e përkohshme të aseteve.
8. Urdhri ndalues po ashtu i dërgohet të pandehurit dhe të gjithë personave që kanë interes në asetin e përcaktuar. Urdhri ndalues cakton shqyrtimin brenda tre (3) javësh dhe në të thuhet: "Pasuria e përcaktuar në urdhrin ndalues është ngrirë për tridhjetë (30) ditë. Shqyrtimi është caktuar. Nëse pretendoni të kundërshtoni ngrirjen e kësaj pasurie, ju duhet të merrni pjesë në shqyrtim dhe do të keni mundësinë të paraqitni argumentet tuaja për heqjen e kësaj ngrirjeje. Ndalimi afatgjatë i kësaj pasurie mund të urdhërohet në këtë shqyrtim dhe kjo prek të drejtën tuaj në këtë pasuri."
9. Urdhri ndalues nga ky nen ka efektin e mëposhtëm:
 - 9.1. Çdo bankë apo institucion financiar që pranon urdhrin nga ky paragraf menjëherë ndalon çfarëdo aktiviteti të mëtejme të llogarisë bankare të përshkruar në urdhrë. Banka nuk është përgjegjëse ndaj mbajtësit të llogarisë bankare për veprimet e saj në pajtim me urdhrin nga ky paragraf.
 - 9.2. Cilado palë tjetër që pranon urdhrin nga ky paragraf duhet të ndërmerr hapat e arsyeshëm për t'iu bindur urdhrit.

të gjatë kishin proklamuar me retoriken që së shpejti do të hartojnë dhe miratojnë ligjin e ashtuquajtur si ligji "anti-mafia", por që në fakt rezultoi të jetë pikërisht Ligji për Kompetencat e Zgjeruara, efektet e së cilit nuk janë matur ende për shkak të mungesës së referimit në të, gjatë shqyrtimit të procedurave dhe modelit të konfiskimit të pasurisë. Me gjithë retorikën për nxjerrjen e një ligji të tillë që "përbushë standardet evropiane" dhe konsiderohej si një e arritur e madhe e ministrisë dhe e qeverisë, ne kemi analizuar rrjedhën dhe logjikën prej së cilës ka derivuar ky ligj, për çfarë do të flasim më tutje, dhe i cili në fakt, as edhe pas tre vitesh të hyrjes në fuqi nuk ka prodhuar asnjë efekt real. **Por para se** të dalim tek matja e efekteve të ligjit, është me rëndësi të adresohet komplet agjenda mbi të cilën ka evoluar konfiskimi i pasurisë në Kosovë. Fillimisht, Ministria e Drejtësisë në fund të vitit 2009 kishte miratuar Ligjin për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara ose të Konfiskuara, me të cilin ligj ishte i paraparë edhe themelimi i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Çështja që shtrohet me këtë rast është në fakt pakuptimësia për të themeluar një institucion që do të merret me administrimin e pasurisë së konfiskuar përderisa ende nuk kishte një ligj përmes së cilit ajo pasuri do të konfiskohej. Si rrjedhojë, që në hapat e parë ishte e qartë se nuk po ndërtohej një "politikë" e mirëfilltë e konfiskimit por se po konstituoheshin mekanizma mbi të cilët nuk kishte konsistencë të mjaftueshme. Me gjithë shenjat se procesi i konsolidimit të sistemit të konfiskimit të pasurisë në Kosovë po vendosej, dhe pas hartimit të një drafti të parë të ligjit nga ana e MD-së i cili u shtrua për diskutim, u vërejt se gatishmëria për të pranuar rekomandimet e shoqërisë civile nuk ishte në nivelin e pritjeve të duhura. Shoqëria civile e mbledhur në një forum prej disa organizatave joqeveritare hartoi disa rekomandime të cilat në qoftë se nuk përfshiheshin në projektligj atëherë konsiderohej se ky projektligj do të ishte tërësisht i kotë, meqenëse nuk ishte duke u synuar asgjë e re ngase siç kemi konstatuar më lartë, dispozitat kryesore që përmbante ky projektligj tashmë ishin të rregulluara me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë (Kodin Penal të Kosovës, Kodin e Procedurës Penale të Kosovës). Si pjesë e rekomandimeve të akterëve të shoqërisë civile ishin:

1. *Ndryshimi i emrit të draft-ligjit, i cili në të njëjtën kohë do të duhej të reflektonte në fushëveprimin dhe qëllimin e tij. Rekomandimi ishte që kualifikimi "pasuritë e fituara me kryerjen e veprës penale", të ndryshohej me "pasuritë e fituara në*

mënyrë të paligjshme” (edhe për rastet kur nuk ka të bëjë me vepër penale).

2. *Pasuria e përfituar në mënyrë të paligjshme të vërtetohet nga i dyshuari, e jo sipas detyrës zyrtare. Me bartjen e barrës së provës tek të dyshuarit, do të rritej mundësia e luftimit më efikas të krimit të organizuar dhe pasurisë së paligjshme. Një përvojë e tillë çfarë rekomandohej tashmë ishte dëshmuar e suksesshme në shtetet e rajonit, si Shqipëria,¹⁵ Sllovenia e Bullgaria.*
3. *Ky draft-ligj do të duhej të zbatohet edhe për pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme të personave të dyshuar, të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra të lejohej retroaktiviteti i tij, duke filluar nga dhjetori i vitit 1999, pas krijimit të rrethanave të reja politike në Kosovë.*
4. *Sugjerohej krijimi i mekanizmave të veçanta brenda institucioneve ekzistuese (polici, prokurori, gjykata) me qëllim të zbatimit më efikas të legjislacionit të kësaj fushe, etj.*

Me gjithë retorikën mediale ku tentohej të balancohej deficitin përmbajtësor i ligjit me terminologjinë anti-mafia që MD-ja promovonte, gatishmëria për të përfshirë një numër rekomandimesh që do ta bënin këtë ligj më efikas nuk u realizua. Madje mbulesa e përmbajtjes së këtij projektligji nën epitetin se ai i plotëson të gjitha standardet e Bashkimit Evropian ishte e paqëndrueshme, pasi që siç kemi shpjeguar në kapitullin e parë, nuk ka ndonjë sistem unik brenda Bashkimit Evropian sipas së cilit funksionon konfiskimi i pasurisë dhe se vendet anëtare të BE-së, këtë fushë e kanë të rregulluar me legjislacionet e tyre nacionale.

Ligji për Kompetencën e Zgjeruar për Konfiskim të Pasurive të Fituara me Vepër Penale,¹⁶ e ka rregulluar në atë mënyrë që mund të konfiskohen vetëm pasuritë të cilat janë fituar me vepër penale. Duhet të ekzistojë fillimisht një aktgjykim me të cilin një person shpallet fajtor për një vepër penale, pastaj nëse pasuria e të dënuarit është e fituar me atë vepër penale ose në rrethana të njëjta me

ato të veprës penale, mund të bëhet kërkesa për konfiskimin e asaj pasurie. Dispozita të tilla kanë qenë dhe janë në fuqi në Kodin Penal të Kosovës që nga muaji prill 2004, kur edhe ka hyrë në fuqi Kod i Përkohshëm Penal, dhe pastaj me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Përvoja ka dëshmuar se fare pak raste të konfiskimit të formës së prerë janë realizuar bazuar në këto norma penale. Ligjërisht ka qenë dhe mbetet e vështirë për të vërtetuar lidhjen shkak-pasojë, për të vërtetuar atë se me këtë vepër penale është fituar pasuri e caktuar. Fillimisht duhet të vërtetohet dhe faktohet fajësia për veprën e caktuar penale e pastaj të bëhet vërtetimi se me atë vepër penale është fituar edhe pasuria e të dënuarit. Për më tepër, ligji i ri përveçse ka përsëritur dhe është bazuar në bazën ekzistuese ligjore, ka përjashtuar mundësinë për t'u marrë me atë “lloj të pasurisë” të poseduar nga persona me funksione të larta zyrtare, apo atë që teoria bashkëkohore e njeh si “sistemin kleptokratik”. Pra, Ligji për Kompetencat e Zgjeruara mund të konsiderohet para së gjithash një aneks mbi kompetencat e prokurorëve, gjykatësve, hetuesve dhe strukturës institucionale mbi konfiskimin e pasurisë, vetëm si zgjatje alternative atëherë kur Kodi i Procedurës Penale nuk ishte i mjaftueshëm, por nuk ishte një ligj themelor që do të vendoste një bazë të mirëfilltë të politikës shtetërore për konfiskim. Karakteri i këtij ligji pretendon të përfytyrojë një sistem të pastër penal, duke iu referuar kryesisht personave që kanë kryer vepër penale.¹⁷ Kjo e minon debatin nëse ky format është i duhuri dhe nëse ai ofron garanci që akterët e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik të nivelit institucional të njohur si “jaka e bardhë” mund të jenë subjekt i tij. Megjithatë, para se të shtrojmë në debat çështjet që ne i konsiderojmë si të rëndësishme për t'u trajtuar dhe të cilat duhet të zënë vend në shqyrtimet e ardhshme të Ligjit për Konfiskim të Pasurisë, është me rëndësi të dihet shkalla se sa ky ligj ekzistues është implementuar dhe se çfarë efektesh ka arritur. Për të ndërtuar një përfytyrim të tillë, Çohu! ka ndërmarrë një seri intervistash me akterët implementues dhe bartësit institucional të luftës kundër krimit të organizuar.

Kështu sipas Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik,¹⁸ natyra e konfiskimit të pasurisë duke u bazuar në Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara deri më tani

15 Siç është rasti me disa vende të rajonit p.sh. Republika e Shqipërisë, Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë neni 21 pika 3 thotë: “Barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi”

16 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 5. 8 Mars 2013, Ligji Nr. 04/L-140, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8651>;

17 Po aty, Neni 2;

18 Intervistë e zhvilluar në Zyret e Prokurorisë së Shtetit, me Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, z. Shqipidon Fazliu, me datë 24 gusht, 2015 në orën 10:00.

nuk shërben si një bazë e mirëfilltë për të kuptuar se a është duke funksionuar ky sistem. Sipas tij, ka një mori problemesh që e shoqërojnë tërë strukturën e konfiskimit për arsyet që janë të natyrës legislative, implementuese dhe menaxhuese, ndër të cilat janë veçuar si në vijim:

- Ligji për Kompetencat e Zgjeruara, ndonëse i dedikuar për t'u dhënë më shumë hapësirë prokurorëve, hetuesve dhe gjykatësve, dhe parimisht në dukje një ligj i mirë dhe me përmbajtje, në realitet nuk ka shërbyer ende edhe pas tri vitesh të miratimit të tij, si një mekanizëm që ofron rezultate. Deri me tani, asnjë rast nuk është zgjidhur ekskluzivisht duke iu referuar këtij Ligji, dhe se konfiskimi i pasurisë ka vazhduar të bëhet mbi bazën e parimeve dhe procedurave të përcaktuara në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Kësisoj, rrjedh që rishikimi i legjislacionit për konfiskimin e pasurisë i cili është nisur tani nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, po bëhet pa e ditur në asnjë rast se çfarë përfaqëson ky ligj ekzistues.
- Problemet e terminologjisë së pa definuar në mënyrë precize shpeshherë kanë qenë pengesë për prokurorët dhe hetuesit për të ndërmarrë në mënyrë të pavarur hetime që lidhen me natyrën e veprave penale në të cilëve do të duhej të pasonte konfiskimi i pasurisë. Për të ilustruar këtë, Fazliu përmend një rast në të cilin “janë konfiskuar 86 kg substanca narkotike, por nuk është konfiskuar vetura në të cilën është gjetur sasia e substancave narkotike”.
- Natyra e konfiskimit të deritanishëm kryesisht është lidhur me vepra penale të krimit të organizuar, pasuria e bartësve të të cilit ka qenë e përqendruar në ndërtesa, shtëpi, motele dhe vetura, nga të cilat, përjashtuar veturat, patundshmëritë tjera nuk kanë mundur të konfiskohen. Përveç kësaj, Fazliu kritikon edhe mënyrën e menaxhimit të pasurive të sekuestruara apo konfiskuara, për të cilat nuk ka një operim efikas, pikërisht si pasojë e procedurave të tej zgjatura që burojnë nga baza ligjore.
- Sipas Fazliut, Ligji për Kompetencat e Zgjeruara është dashur të përcillet me ngritjen e kapacitetit institucional, përkatësisht me prokurorë dhe hetuesë të specializuar që do të merreshin ekskluzivisht me implementimin e direktivave që burojnë nga ai. Meg-

jithatë një gjë e tillë nuk është bërë. Përjashtuar disa trajnime të nivelit lokal në të cilat kanë marrë pjesë një numër i prokurorëve dhe hetuesve, përgjithësisht nuk ka prokurorë dhe hetuesë të specializuar që merren ekskluzivisht me konfiskimin e pasurisë;

- Indikatorët nxitës apo indiciet për të filluar një proces konfiskimi sipas praktikës bashkëkohore do të duhej të rrjedhin nga disa parametra siç janë stili i jetës, pasuritë e patundshme dhe financiare, të cilat do të paraqesin një shpërputhje me standardin e punës dhe profesionit të një zyrtari apo një qytetari të caktuar. Megjithëse siç është specifikuar përdërisa sistemi i konfiskimit në Kosovë ka bazë penale, atëherë asnjë indikacion nuk mund të merret si i qenë përdërisa bartësit e tyre të mos jenë dënuar paraprakisht për një vepër penale;
- Sipas Fazliut, është mëse e nevojshme që të rishqyrtohet dhe të ndryshohet legjislacioni aktual për konfiskimin e pasurisë, përkatësisht, një ligj i ri me karakter të plotë të konceptit të njohur si “anti-mafia” që do të plotësonte boshllëqet e hasura deri me tani në fushën e konfiskimit të pasurisë;

Nga akterët e zinxhirit implementues të konfiskimit të pasurisë, është edhe sektori i gjyqësisë. Një perspektivë të konfiskimit të pasurisë dhe vlerësimeve që ndërliken me legjislacionin në fuqi, e kemi marrë edhe nga intervista me Kryetarin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, Bashkim Hasanin.¹⁹ Sipas tij, ligji aktual ka qenë një përsëritje e legjislacionit ekzistues dhe se një ligj i ri është tejet i nevojshëm. Hasani po ashtu konsideron se rastet e trajtuara me bazën penale që ekziston në Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara kanë qenë kryesisht raste që lidhen me vepra penale të krimit të organizuar, përkatësisht me një natyrë kriminale siç është prostitucioni, droga apo trafikimi, me ç’rast gjyqtarët dhe prokurorët sipas tij, ende nuk kanë trajtuar dhe nuk kanë ndërtuar një përfytyrim se si duket një rast i konfiskimit që lidhet me zyrtarë të lartë publik. Nevoja për një ligj të ri duhet të drejtohet nga përvoja e deritanishme, dhe të tejkalojë nocionet e lidhura ngushtë me vepra penale, pra të ketë tiparet e ligjit “anti-mafia” ku natyra e konfiskimit të kalojë gradualisht edhe tek modeli i bazuar në aspektin civil.

Një këndvështrim pak më të mbyllur dhe më të rezervuar

¹⁹ Intervistë e realizuar me Kryetarin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, Bashkim Hasanin me datë 2 shtator, 2015, në zyrat e Gjykatës Themelore të Ferizajt;

“

Një indikator i rëndësishëm për të kuptuar shkallën e zbatimit të ligjit aktual dhe për të pasur një të kuptuar më të thellë mbi atë se si është implementuar politika e konfiskimit të pasurisë në Kosovë, janë edhe statistikat e konfiskimit të pasurisë si dhe analizat përcjellëse të tyre.

sa i përket funksionimit të Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara e reflekton Ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi.²⁰Për Kuçin, ligji ka qenë shumë i mirë, një standard i avancuar madje jo vetëm për Kosovën por i krahasueshëm me ligjet më të mira në nivel të BE-së dhe i cili rregullon fushën e konfiskimit të pasurisë sipas parametrave dhe kapaciteteve institucionale që ka aktualisht Republika e Kosovës. Megjithatë, Kuçi, ministria e të cilit është duke menduar për hartimin e ligjit të ri “anti-mafia” e pranon se ka mundësi për tu bërë një numër i madh ndryshimesh që do të kontribuonin drejtpërdrejtë tek gjykatësit, prokurorët dhe hetuesit, për t’u dhënë atyre një qasje më sistematike. Për ministrin e Drejtësisë, ka nevojë për ekipe të specializuara që do merren me konfiskimin e pasurisë (të cilat gjatë këtyre dy viteve nuk janë ndërtuar asnjëherë: koment i Çohu!) dhe se kjo do të adresohet në ligjin e ri. Pavarësisht dëshirës për të pasur një retorikë pro një ligji “anti-mafia” ku do të ndryshonte edhe sistemi i bazës së konfiskimit nga ajo tërësisht penale në një sistem të kombinuar penale-civile, dhe ku barra e provës të kalonte nga organet e hetuesisë tek i dyshuari, ministri Kuçi është më i rezervuar dhe ngurron të pranojë se ministria që ai drejton është duke menduar mbi këto linja. Një nga problemet që Kuçi i konsideron si pengesa për të kaluar në një sistem civil të konfiskimit lidhet edhe me çështjet e shumta ndër sektoriale, për të cilat ende nuk ka një konformitet. Për shembull, pronësia e pa definuar dhe e pa legalizuar e pasurive të patundshme, të ndara sipas mënyrës tradicionale, sipas tij, paraqet një problem

që argumenton se një sistem civil i konfiskimit që vlen për të gjithë qytetarët e Kosovës do të ishte vështirë i implementueshëm. Ministri Kuçi insiston në avancimin dhe ndryshimin e ligjit, ndryshimet kryesore të së cilit do të jenë të shtruara sa i përket çështjes së barrës së provës, pastaj mekanizmave implementues dhe harmonizimit të terminologjisë juridike të ligjit me Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale, por jo edhe në një frymë të re të konceptit “anti-mafia”.

Një indikator i rëndësishëm për të kuptuar shkallën e zbatimit të ligjit aktual dhe për të pasur një të kuptuar më të thellë mbi atë se si është implementuar politika e konfiskimit të pasurisë në Kosovë, janë edhe statistikat e konfiskimit të pasurisë si dhe analizat përcjellëse të tyre.

²⁰ Intervistë e realizuar me datë 26 gusht, 2015 me ministrin e Drejtësisë, Hajredin Kuçi, në Ministrinë e Drejtësisë;

2.1 STATISTIKAT E SEKUESTRIMIT DHE KONFISKIMIT TË PASURISË NË KOSOVË – TË DHËNAT KONTRADIKTORE

Në kategorinë gjithëpërfshirëse të politikës së konfiskimit të pasurisë përgjithësisht ekzistojnë tri nocione themelore: ngrirja, sekuestrimi dhe konfiskimi. Natyrisht se si kategori në vete secila paraqet një shtyllë me specifika dhe procedura të veçanta nga njëra-tjetra. Në Kosovë, shpesh herë këto nocione paraqiten të ngjashme për nga mënyra se si institucionet i interpretojnë të dhënat statistikore. Më konkretisht, tendencat për të paraqitur punën efektive me shifra madhore të sekuestrimit si konfiskim është shpesh e pranishme. Si rrjedhojë, shpesh herë kemi hasur në shifra të ndryshme të konfiskimit të pasurisë ndër vite, kontradikta këto që janë dhënë në paraqitjet tabelore në vijim. (Shih tabelën nr. 1)

Të dhënat e paraqitura në tabelën e më sipërme tregojnë për një diskrepancë statistikash, për faktin se në njërin anë figurojnë shifrat e sekuestrimit ndërsa në anën tjetër ato të konfiskimit dhe që në të shumtën e rasteve janë më të mëdha. Rrjedhimisht, për shembull nëse në vitin 2012, kemi 2 raste sekuestrimi, në po të njëjtin vit kemi 21 raste konfiskimi. Këtu çështja shtrohet sipas rrjedhës logjike se konfiskimi është akti final pas vendimit përfundimtar të gjykatës ndërsa sekuestrimi një akt i përkohshëm, dhe shifrat e larta dhe në disproporcion të konfiskimit në raport me sekuestrimin kanë tendencë për të lajthitur një analist të pavarur që merret me këtë aspekt.

Për më tepër, nga po i njëjti burim, përveçse në një raport të ndarë, figuron që natyra e asetëve të konfiskuara në periudhën para nxjerrjes së ligjit aktual, ishte përgjithësisht tranzitore, të cilën e përbënin në masë të

madhe kafshët shtëpiake, veturat dhe mjetet tjera të cilat ishin zënë gjatë kryerjes së veprës kriminale.²¹ Pra, deri me nxjerrjen e ligjit të ri, konfiskimi i pasurisë kishte ndjekur një trend të tillë që merrej vetëm me pasurinë dhe asetet të cilat ishin përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale duke mos u futur më thellë në vetë natyrën e krimit të organizuar dhe në pasurinë që tashmë posedohej nga aktiviteti kriminal.


Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara përmes së cilit pretendohet të arrihej ndërtimi i sistemit të konfiskimit të pasurisë në Kosovë, mund të shihen disa efekte përmbajtjesore si nga ana e natyrës së konfiskimit ashtu edhe nga vlerat e konfiskimit. Megjithatë, edhe në këtë drejtim është vështirë të precizohet me saktësi vlera e pasurisë që shteti e ka ngrirë, sekuestruar apo konfiskuara. E shumta që mund të bëhet nga të dhënat statistikore, është ndërtimi i një përfytyrimi se me të vërtetë ka pasur një trend përherë e më të madh të sekuestrimit dhe konfiskimit. Kështu për shembull, tabela në vijim paraqet statistikën e konfiskimit të pasurisë për vitet 2013, 2014 dhe 2015, sipas një raporti të Grupit për Studime Juridike dhe Politike. (Shih tabelën nr. 2)

21 Ministria e Drejtësisë, Ftesë për Ankand Publik, AAPSK, dt. 07.03.2011: http://www.gazetajnk.com/repository/docs/23_02_2011__Ftes_per_ankand_public_Referenca_AAPSK-003-1.pdf

“


Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara përmes së cilit pretendohet të arrihej ndërtimi i sistemit të konfiskimit të pasurisë në Kosovë, mund të shihen disa efekte përmbajtjesore si nga ana e natyrës së konfiskimit ashtu edhe nga vlerat e konfiskimit.

TABELA NR. 1. STATISTIKAT E ADMINISTRIMIT TË PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE KONFISKUAR PRA HYRJES NË FUQI TË LIGJIT PËR KOMPETENCAT E ZGJËRUARA*



* Raport mbi të dhënat statistikore për administrimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar deri me datë 30.04.2012, Dokument i siguruar nga Gazeta Jeta në Kosovë: <http://www.gazetajnk.com/repository/docs/RAPORTI.pdf>;

TABELA NR. 2. STATISTIKAT E NGRIRJES, SEKUESTRIMIT DHE KONFISKIMIT TË PASURISË NË KOSOVË**



** Grupi për Studime Juridike dhe Politike “Konfiskimi i Pasurisë së Paligjshme në Kosovë: Koha për të menduar një politikë të re”, Raport Politikash nr 6, autor: Albana Rexha, Tetor 2015, fq 14;

Sipas këtyre statistikave të përpunuara nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, rezultojnë që shumica e përgjithshme e pasurisë së konfiskuar për tri vitet e fundit është 92,863.42 Euro. Megjithatë, këto të dhëna bien ndesh me ato që posedon Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik Shqipëri Fazliu. I njëjti, i kontaktuar përmes postës elektronike, ofron shifra të tjera sa i përket vlerës së pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar për vitet në fjalë. (Shih tabelën nr. 3)

Sipas të dhënave të ofruara përmes postës elektronike, shifrat e konfiskimit që posedon koordinatori janë shumë më të larta krahasuar me ato të shfaqura nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, veçanërisht sa i përket konfiskimit.

Megjithatë, diversiteti i të dhënave statistikore është hasur më shumë sesa në një rast të vetëm. Në një tryezë të organizuar nga Lëvizja Fol, me datë 14 nëntor, 2014 Koordinatori Kombëtar Kundër Krimit të Organizuar, për vitin 2014, kishte dhënë statistika të tjera sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit për vitin 2014 krahasuar me ato që janë raportuar përmes postës elektronike. Sipas citimit të gazetës Koha Ditore, që raportonte për organizimin e Lëvizjes Fol, statistikat e sekuestrimit dhe konfiskimit për vitin 2014 ishin 28,968.000.00 Eu-

ro.²² Përgjithësisht, konfuzione të tilla hasen për shkak se ende nuk ka një databazë të caktuar dhe të centralizuar të dhënash sa i përket ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë. Disponimi i të dhënave nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar ndaras nga ato të Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit të Organizuar e bëjnë shpesh herë të vështirë përqendrimin në statistikat finale. Megjithatë, ne kemi marrë për bazë statistikat zyrtare të dhëna në Raportet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit të Organizuar të cilat janë të përshkruara edhe në mënyrë statistikore por edhe për nga natyra e aseteve të sekuestruara apo konfiskuara. (Shih tabelën nr. 4)

Sic mund të shihet, të dhënat nga raporti zyrtar janë më të plota, madje përveç statistikave të detajuara, tregojnë edhe për natyrën e pasurisë së sekuestruar. Në këtë periudhë nuk ka pasur ende ndonjë vendim përfundimtar gjykatë për konfiskim prandaj në raport, Koordinatori Kombëtar nuk ka dhënë shifra të konfiskimit përveçse ka bërë të ditur për numrin e aktakuzave që janë ngritur dhe për vlerën për të cilën janë ngritur ndaj të cilave pritet vendimi i gjykatës. (Shih tabelën nr. 6)

²² Koha Ditore, dt. 16 Nëntor, 2014, artikulli i botuar në versionin elektronik në adresën: <http://koha.net/?id=27&l=33462>;

TABELA NR. 3. VIJIM PARAQET TË DHËNAT E OFRUARA BAZUAR NË KORRESPONDENCËN E HARTUESVE TË KËTIJ PUNIMI DHE SHQIPDON FAZLIUT: ***

	VLERA E PASURISË SË SEKUESTRUAR	VLERA E PASURISË SË KONFISKUAR
2013	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
2014	€ 31,000.000.00	€ 500.000.00-1,000.000.00
2015 (deri në qershor)	€ 16,000.000.00	€ 100.000.00

*** Korrespondenca elektronike e shkëmbyer me datë 01 Tetor, 2015;

Në periudhën prill - qershor vërehet se shkalla e seriozitetit dhe përpjekjeve për të sekuestruar pasurinë e përfutur nga veprat penale ka vazhduar trendin pozitiv. Në këtë periudhë kemi edhe sekuestrimin e një fabrike, përkatësisht fabrikës së përpunimit të armaturës, "FAN" rreth rastit të së cilës ishin hetuar dhe sekuestruar pasuritë e disa anëtareve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Vlera e pasurisë së sekuestruar për rastin e FAN, konsiderohet të ketë qenë disa milionëshe dhe që përmbante xhirollogaritë bankare, tokat dhe pasuritë e paluajtshme si dhe makineri të ndryshme.²³

Një rast tjetër që paraqet storie suksesi të sekuestrimit në periudhën në fjalë, është edhe rasti i ish gjyqtarit Kolë Puka, i cili ishte dënuar me 10 vite për vepra penale që lidheshin me keqpërdorimin e autoritetit zyrtar, lëshimin e dokumenteve të falsifikuara, fiktive etj. Pas shqiptimit të dënimit për veprat penale ndaj Pukës, organet kompetente kanë konfiskuar shtëpinë luksoze në qytetin e Klinës si dhe kanë sekuestruar vilën në Ulqin.

Në përgjithësi, viti 2014 ishte një vit me shifra përgjithësisht të një trendi në rritje e sipër. Vlera e përgjithshme e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë për vitin 2014 sipas raportit

zyrtar të Koordinatorit Kombëtar ishte 31,000.000.00 Euro, nga të cilat 500.000.00- 1,000.000.00 ishin pasuri e konfiskuar, përkatësisht 30 kg ari.²⁴

Në vitin 2015, në tremujorin e parë, për dallim nga vitet para-prake ka pasur edhe lëndë të përfunduara nga gjykatat në formën e vendimeve të prera me ç'rast ka pasur edhe konfiskime. Natyra e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë në periudhën janar- mars 2015 sipas raportit të Koordinatorit Kombëtar ka qenë si vijon:²⁵ (Shih tabelën nr. 5)




Siç mund të shihet nga të dhënat statistikore dhe natyra e pasurive të sekuestruara apo konfiskuara, përgjithësisht vlera e konfiskimeve përfundimtare është tejet e ultë në krahasim me sekuestrimin. Kjo mund të aludojë në probleme të sistemit të drejtësisë në përgjithësi siç janë lëndët e shumta dhe mungesa e fleksibilitetit për të trajtuar këto lëndë me prioritet, mungesa e argumenteve juridike dhe provave për të ndërlidhur veprën penale me pasurinë e palës apo edhe thjeshtë tek paaftësia e gjyqësorit për të trajtuar raste që janë të një shkalle

23 Gazeta Zëri, 23.07.2014; <http://old.zeri.info/artikulli/42781/pasuria-30-milione-she-e-sekuestruar> ;

24 Këshilli Prokurorial i Kosovës, Raport tremujor mbi aktivitetet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit të Organizuar, Periudha tetor-dhjetor 2014, fq. 17, [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_\(tetor_-_dhjetor_2014\)_shqip.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_(tetor_-_dhjetor_2014)_shqip.pdf)

25 Këshilli Prokurorial i Kosovës, Raport tremujor mbi aktivitetet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit të Organizuar, Periudha janar-mars 2015, [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_\(janar_-_mars_2015\)_shqip_-_per_publicim.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_(janar_-_mars_2015)_shqip_-_per_publicim.pdf);

TABELA NR. 4. TË DHËNAT NGA RAPORTI PËR PERIUdhËN JANAR- MARS , 2014****

SEKUESTRIMET	 5 SHTËPI	 PALUAJTSHMËRI 366.227 M2
	 9 BANESA	
	 1 MOTEL	 PARA: € 577.222
	 OBJEKT BANIMI 7 KATESH	 6 VETURA
		 TOKË 16.63 ARI
	NGRIRJET	€258.006
KONFISKIMET	0	

**** Prokurori i Shtetit, Raporti tremujor janar-mars 2014, i Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.499.2014-Raport_tremujor_Janar-Mars_2014-Per_aktivitete_dhe_rekomandi....pdf;

TABELA NR. 5. NATYRA E SEKUESTRIMIT DHE KONFISKIMIT TË PASURISË NË PERIUdhËN JANAR- MARS 2015 SIPAS RAPORTIT TË KOORDINATORIT KOMBËTAR KA QENË SI VIJON: *****

TË NGRIRA	TË SEKUESTRUARA	TË KONFISKUARA
23,250 EURO, 500 CHF, 300 USD;	241.420 EURO	ASETE NË VLERË 64.487 EURO
13 BIZNESE-OBJEK- TE-POMPA TË BENZINËS; VILLA SWISS, 14.500 M2;	BANESË 76.3 M2;	
5 VETURA	1 VETURË	
14.500 M2 TOKË		
74 REZERVUARE TË NAFTËS;		

***** Këshilli Prokurorial i Kosovës, Raport tremujor mbi aktivitetet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit të Organizuar, Periudha janar-mars 2015, [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_\(janar_-_mars_2015\)_shqip_-_per_publicim.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_(janar_-_mars_2015)_shqip_-_per_publicim.pdf);

TABELA NR. 6. TË DHËNAT NGA RAPORTI PËR PERIUdhËN PRILL- QERSHOR, 2014*****



të lartë dhe që ndërlidhen drejtpërdrejtë me zyrtarë të lartë publik.

Ndonëse shifrat e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë për vitin 2015 deri në periudhën raportuese korrik-shtator 2015 kanë arritur shifrën prej 20 milionësh,²⁶ konfiskimet e formës së prerë mbesin ende të mangëta. Megjithatë, në periudhën e fundit, përkatësisht në fillim të muajit nëntor, nga Gjykata Themelore e Ferizajt, është konfirmuar vendimi i formës së prerë për konfiskimin e një pasurie në vlerë prej 1.5 milion Euro,²⁷ ndër rastet më të mëdha deri më tani të konfiskimit nga një akt i vetëm, dhe që paraqet një stimulim shtesë për të shpresuar se një trend i tillë do të vazhdojë të rritet.

Një problem që haset në raportet periodike të Koordinatorit Kombëtar, dhe që është indikator i drejtpërdrejtë i

mungesës së më shumë rasteve të konfiskimit derivon nga mungesa e përkushtimit nga ana e gjykatësve dhe prokurorëve për të ndjekur një agjendë strikte dhe të përfillshme të rasteve që paraqiten për sekuestrim apo konfiskim. Përgjithësisht, një numër i madh i rasteve që ka tendencë të jenë raste potenciale për konfiskim apo sekuestrim të pasurisë, shpesh herë ngelen pa u trajtuar apo shtyhen në afate të pacaktuara. Si rrjedhojë, me gjithë përpjekjet e Koordinatorit Kombëtar për të nxitur sa më shumë diskursin mbi rëndësinë e konfiskimit të pasurisë si mjet për të goditur drejtpërdrejtë krimin e organizuar, ende nuk mund të flitet për një agjendë të mirëfilltë institucionale që e ka për prioritet këtë fushë. Për të parë dhe krahasuar mendësinë aktuale dhe sfidat e Republikës së Kosovës për të ndërtuar një politikë të tillë, kemi trajtuar shkurtimisht në kapitullin vijues sistemet e konfiskimit të pasurisë nga disa vende të rajonit, nga të cilat ka edhe shumë histori suksesi.

26 Raporti i Koordinatorit Kombëtar në Këshillin Prokurorial të Kosovës, cituar nga portali elektronik i gazetës Koha Ditore me datë 05 nëntor, 2015, <http://koha.net/?id=27&l=82956>;

27 Gazeta Koha Ditore, 9 nëntor, 2015, fq 5;



03

**KONFISKIMI I
PASURISË NË
LEGJISLACIONIN
DHE PRAKTIKËN
RAJONALE**

3.1 PËRMBAJTJA E LEGJISLACIONIT MBI KONFISKIMIN E PASURISË NË VENDET E RAJONIT

Vendet e rajonit me të cilat përkufizohet Kosova, kanë për afërsisht karakteristika të përbashkëta politike e institucionale. Parimisht, përjashtuar Kroacinë e cila tashmë është vend anëtar i BE-së, Serbia, Bosnja, Mali i Zi, Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova janë të gjitha në trajektoren e tillë me tendenca të qarta për integrimin në Bashkimin Evropian. Si rrjedhojë e kësaj agjende integruese, këto shtete kanë marrë për bazë zhvillimin e shumë fushave që i përafrojnë me BE-në, veçanërisht në ato që lidhen me sundimin e rendit dhe ligjit. Konfiskimi i pasurisë po ashtu është një nga fushat e politikave institucionale në të cilën këto shtete kanë vendosur bazat ligjore dhe janë duke ndërtuar sistemet e tyre përkatëse. Më tutje, do të japim një pasqyrim të shkurtër të sistemeve të konfiskimit të pasurisë të disa prej vendeve të rajonit që paraqesin sisteme të ndryshme në mes vete.

3.1.1 Shqipëria

Republika e Shqipërisë në vitin 2009 ka miratuar Ligjin për **“Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë”**²⁸ Ky ligj, i njohur në retorikë si “ligji anti-mafia” parasheh konfiskimin mbi bazën penale por krahas

kësaj, parasheh edhe procedurën civile të konfiskimit. Neni 6 i Ligjit përcakton objektin e verifikimit të tij duke listuar mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale, nivelin ekonomik si dhe burimin e të ardhurave. Mbi këto objekte verifikimi mund të shihet tendenca për ta materializuar logjikën “anti-mafia” dhe kjo listë verifikimi parimisht është mjaft gjithëpërfshirëse dhe mund të shërbejë si një bazë e mirë për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë. Ligji anti-mafia në Shqipëri është i aplikueshëm për personat fizikë dhe të afërmit e tyre si dhe personat juridikë. Parimi themelor i bazës së vendosur me ligjin anti-mafia në Shqipëri qëndron në faktin se procedurat civile të konfiskimit janë të pavarura nga “kushtet, niveli dhe përfundimi” i procedurave penale të ushtruara ndaj subjekteve.²⁹

Ligji në fjalë, është një vazhdimësi e logjikës së sundimit të rendit dhe ligjit të vendosur më herët edhe me Ligjin për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar të vitit 2004. Rrjedhimisht ndryshimet e proceduara kanë pasur për qëllim luftimin akoma më të madh të krimin të organizuar si një nevojë permanente e brendshme, po aq sa edhe kërkesë e Bashkimit Evropian, tendenca këto të shfaqura mjaft hapur në Ligjin ekzistues.

Sistemi i përzier i Shqipërisë është strukturalisht më i avancuar sesa ai i Kosovës apo shumicës së vendeve

28 Republika e Shqipërisë, Ligji nr 10.192, datë 03.12.2009; http://www.pp.gov.al/ëeb/ligj_per_parandalimin_dhe_goditjen_e_krimit_te_organizuar_dhe_trafikimit_nepermjet_masave_parandaluese_kunder_411.pdf;

29 Alan Bacarese and Pedro Gomes Pereira, **“Technical Paper on Criminal Asset Recovery System in Serbia and Comparative Analysis with other Systems in Central and Western Europe”** Council of Europe, July, 2010, fq. 13; https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/projects/car_serbia/Technical%20papers/2358-CAR-TP18_%202010.pdf;



Si rrjedhojë e kësaj agjende integruese, këto shtete kanë marrë për bazë zhvillimin e shumë fushave që i përafron me BE–në, veçanërisht në ato që lidhen me sundimin e rendit dhe ligjit.

të rajonit, pikërisht duke u bazuar në mundësinë e konfiskimit me procedurë civile, dhe ka prodhuar deri me tani disa efekte dhe pritet të ketë ndikim edhe më të madh, përderisa kohëve të fundit janë vërejtur tendenca përherë e në rritje për luftimin e krimit të organizuar, pastrimit të parasë dhe luftimin e korrupsionit dhe dekriminalizimit të akterëve politik.

3.1.2 Serbia

Pas përpjekjeve për të konsoliduar demokracinë, Serbia ka shfaqur pretendimet e saj që të jetë pjesë e Bashkimit Evropian, duke synuar kështu përmbytjen e obligimeve që dalin në kuadër të kushteve për anëtarësim. Konsolidimi i qeverive demokratike megjithatë është shoqëruar me shumë probleme të natyrave të ndryshme. Për një kohë të gjatë Serbia ka qenë vend ku krimi i organizuar ka qenë aq i fuqishëm sa që ka arritur të pengojë kalimin tranzicional nga ish socializmi në ekonominë e lirë të tregut.³⁰ Në këtë aspekt, qeveritë e ndryshme përgjatë dhjetë viteve të fundit kanë marrë përsipër përpjekjet për të ulur shkallën e krimit të organizuar. Si rrjedhojë, një mori iniciativash ligjore që janë ndërmarrë, janë të modelit evropian, në të cilat vërehet tendenca për të përshtatur legjislacionin vendas me atë të Bashkimit Evropian. Një

nga ligjet e tilla, është edhe ai mbi **“Mbajtjen dhe Konfiskimin e Pasurisë së fituar përmes Krimit”**.³¹ Ky ligj trajton pasurinë e fituar përmes veprave penale të përcaktuara në 13 Nene të Kodit Penal të Serbisë, duke i dhënë kështu tiparet e një politike konfiskimi me bazë penale. Për nga struktura menaxhuese dhe implementuese e ligjit, janë përcaktuar dy organe themelore që ushtrojnë veprimtarinë e implementimit të tij, përkatësisht Njësia e Inteligjencës Financiare dhe Drejtoriat për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.³² E veçanta e Ligjit për Konfiskimin e Pasurisë në Serbi është fakti se krahas karakterit penal dhe ndërlidhjes së konfiskimit me veprën penale të gjykuar, kompetencat për nisjen e hetimeve janë të definuara në kuadër të veprimtarisë së Njësies së Inteligjencës Financiare, konkretisht, indiciet për të hetuar një pasuri zhvillohen sipas parametrevave të kësaj njësie. Ligji për Konfiskim të Pasurisë i Republikës së Serbisë po ashtu definon në mënyrë mjaft të theksuar të gjithë shkallën e procedurave dhe veçanërisht ato që kanë të bëjnë me ballafaqimin e palëve në gjykatë. Me gjithë bazën ligjore që vazhdimisht ka qenë subjekt i tendencave për të shënuar përparim, rastet e konfiskimit të pasurisë së përfituar nga krimi i organizuar ende janë brenda margjinës rajonale. Përkatësisht, konfiskimet e pasurisë në Serbi sillen mesatarisht me 6-10 raste për vit kalendarik.³³

30 OSCE **“Policing the Economic Transition in Serbia”** Belgrade, Feb, 2005, fq 6-7; <http://www.osce.org/serbia/18312?download=true>;

31 Ligji për Mbajtjen dhe Konfiskimin e Pasurisë nga Krimi: <http://www.ohchr.org/Documents/Issues/Mercenaries/WG/Law/Serbia/LawOnSeizure.pdf>;

32 Po aty, neni 6 dhe 8;

33 Shih Raportin e Progresit për Serbinë, 2013: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/sr_rapport_2013.pdf;

3.1.3 Rumania

Rumania deri vonë konsiderohej si një ndër vendet më të korruptuara të Bashkimit Evropian.³⁴ Megjithatë, viteve të fundit janë bërë përpjekje të mëdha dhe janë funksionalizuar një numër agjencishë dhe institucionesh relevante për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, të cilat kanë dhënë rezultate të kënaqshme. Në termat e konfiskimit të pasurisë, Rumania për dallim nga Shqipëria e Serbia, nuk ka një ligj qendror për konfiskim të pasurisë.³⁵ Provizionet ligjore për konfiskim mund të gjenden në disa akte juridike të ndryshme, ndërsa në një vështrim të përgjithshëm, Rumania aplikon tre lloje konfiskimesh:

- Konfiskimin me Bazë Penale të përcaktuar me Kodin Penal në të cilin përfshihen veprat e krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parasë, trafikimit me qenie njerëzore, trafikimit të armëve dhe drogës etj. Subjekti i konfiskimit në këtë rast janë të gjitha ato pasuri të përfituara nga kryerja e veprave penale të lartpërmendura, si dhe pasuritë apo asetet me të cilat janë përfituar pasuritë;
- Konfiskimin me Bazë të Procedurës Administrative, në të cilën përfshihen pasuritë e përfituara nga pjesëmarrja në përcaktimin e një vendimi të procedurës administrative dhe që i njëjti ka qenë ilegal; dhe
- Konfiskimin mbi Bazën e Vlerësimit të Agjencisë Kombëtare të Integritetit, e cila në kuadër të vlerësimit të pasurisë, në rast të mospërputhjes së deklarimit të pasurisë me shuma mbi 10,000 Euro të diskrepancës në mes të aseteve të deklaruar dhe atyre të gjetura, konfiskim ky që bartet përmes procedurës civile me vendim gjykatë;

Nga ky këndvështrim, sistemi rumun i konfiskimit edhe pse nuk ka një akt unik përcaktues të të gjitha normave dhe procedurave, prapë se prapë ofron disa mundësi për

konfiskim të pasurisë të cilat do të ishin efektive edhe për vendet tjera të rajonit. Veçanërisht, procedura e konfiskimit mbi bazën e vlerësimit të deklarimit të pasurisë është një mekanizëm shumë i dobishëm dhe që do të mund të aplikohet edhe në Kosovë.

Rastet e trajtuara më lartë, paraqesin një kombinim perspektivash dhe modelesh të konfiskimit të pasurisë të cilat kanë funksionuar dhe funksionojnë mjaft mirë në kuadër të zbatimit të politikës së konfiskimit të pasurisë së përfituar jashtëligjshëm. Përveç sistemeve me bazë penale, siç është ai i Kosovës dhe Serbisë, sistemet tjera të përziera (mikse) kanë një avantazh në këtë drejtim dhe iu përgjigjen më lehtë nevojave reale të konfiskimit të pasurisë jo domosdoshmërisht të lidhur me gjykimin final për një vepër penale.

Duke konsideruar politikën aktuale dhe natyrën si dhe rezultatet e konfiskimit të pasurisë në Kosovë, detyrimisht bëhet e qartë se një lëvizje në drejtim të shqyrtimit të kësaj politike është mëse i nevojshëm.

34 Centrul de Resurse Juridice **“Corruption, Confiscation and Asset Recovery policy in Rumania”** Policy Report, 2013, <http://www.crj.ro/userfiles/editor/files/Raport%20CRJ%20-%20Recuperarea%20produselor%20infractiunilor%20de%20coruptie.pdf>;

35 Transparency International Brochure on Confiscation of Assets in Italy, Rumania and Bulgaria: http://www.transparency.org.ro/proiecte/proiecte_in_desfasurare/proiect_13/Brochure_EN_web.pdf

04

**NJË PERSPEKTIVË
KRAHASUESE
LIGJORE PËR
KONFISKIMIN
E PASURISË NË
KOSOVË**

Në qershor të 2015, Ministria e Drejtësisë, pas një analize të bërë nga ekspertë të brendshëm dhe grupe punuese ndër-sektoriale, ka arritur në përfundim se është e nevojshme të shtrohet për diskutim dhe të hartohet një ligj i ri për konfiskimin e pasurisë në Kosovë.³⁶ Në një koncept dokument të hartuar nga MD-ja si pararendës të nevojës për një debat më të thellë rreth formatit të ligjit të ri që pritet të hartohet, është potencuar nevoja për t'i dhënë rast konfiskimit të pasurisë që ndërlihet me aktivitetin e krimit ekonomik por jo domosdoshmërisht të lidhur me një denim të formës së prerë.³⁷ Kjo është hera e parë që tendencat e tilla dalin në pah nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe i hapet mundësi debatit për një ligj të karakterit të plotë “anti-mafia”. Megjithatë, në rastin më të mirë, duhet shqyrtuar alternativat që Ministria e Drejtësisë është shfaqur e gatshme t'i shtrojë për diskutim.

Ideja që është synuar të shtrohet ka të bëjë me arritjen e një statusi të tillë juridik që konfiskimi i pasurisë të arrihet edhe pa vendime gjyqësore. Megjithatë, një sistem i tillë do të kishte efekte edhe në disa dimensione të tjera, prapë se prapë për shtyllat themelore të sistemit siç është për shembull barra e provës, ministri Kuçi nuk ka qenë optimist, se e njëjta mund t'iu kalojë drejtpërdrejtë personave të akuzuar apo subjekt të konfiskimit. Çështja e **Barrës së Provës** në fakt përbën një nga shtyllat e debatit që duhet të zë vend gjatë procesit të shqyrtimit të ligjit anti-mafia në Kosovë.

36 Ministria e Drejtësisë, <http://www.md-ks.net/?page=1,8,1571>;

37 Ministria e Drejtësisë, Koncept Dokumenti për çështjen e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme: http://www.md-ks.net/repository/docs/Koncept_Dokumenti_per_çështjen_e_pasurise_se_fituar_ne_menyre_te_pajustificuar_-_anti-mafia.pdf;

Deri më tani, barra e provës ka qenë në duar të hetuesisë, policisë dhe gjykatës, të cilat përmes të dhënave dhe fakteve të grumbulluara nga procesi i hetimit, me aktin e shpalljes së vendimit final për subjektin e veprës penale, kanë ndërmarrë edhe procedurat e konfiskimit vetëm deri në masën sa provat e poseduara kanë argumentuar se pasuria e caktuar është përfituar me vepër penale. Kjo natyrisht se e bënë të vështirë edhe punën e organeve të hetuesisë dhe gjyqësisë dhe rrjedhimisht edhe prodhon efekte më të vogla në konfiskimin e pasurisë. Në rastin tjetër, përmes ligjit të ri dhe në mënyrë që i njëjti të ketë karakterin e plotë anti-mafia, barra e provës do të duhet të kalojë nga hetuesia dhe prokurori tek i dyshuari për vepër penale. Veçanërisht nëse tentohet që këtij sistemi të konfiskimit t'ia shtojnë edhe aspektin e konfiskimit mbi bazë civile, është mëse e nevojshme që paralelisht me strukturimin e sistemit, të rregullohet edhe çështja e barrës së provës, dhe veçanërisht për procedurën civile të konfiskimit, në mënyrë që e njëjta të jetë tërësisht në përgjegjësi të subjektit të hetimit. Kjo qasje është kundërshtuar nga ministri Kuçi gjatë takimit në Ministrinë e Drejtësisë, me idenë që një transformim i përgjegjësisë apo barrës së provës dhe për më tepër në një procedurë civile të konfiskimit do të ishte mjaft e vështirë për t'u implementuar në Kosovë për shkak të rrethanave të përgjithshme dhe mungesës së dokumentacioneve, mungesës së regjistrimit të pronave dhe pasurive apo ndarjes së tyre në rrethet familjarë sipas modelit tradicional të trashëgimisë dhe për të cilat nuk ka të dhëna etj. Përveç aspektit të Barrës së Provës, një temë e rëndësishme që duhet shtruar për debat është edhe **Harmonizimi i praktikës për konfiskimin e pasurisë** (Procedura penale vs. Procedura Civile). Duke pasur parasysh se

“

Është e nevojshme që të definohen mirë edhe indiciet apo “red flags” të politikës së konfiskimit mbi bazën civile, në mënyrë që të ketë një bilanc të definuar mirë në mes të respektimit të të drejtave të njeriut, përkatësisht privatësisë dhe të drejtës së prokurorit për të nisur një procedurë hetimore.

deri më tani Kosova ka aplikuar në sistem konfiskimi me bazë penale, ndërsa është duke shfaqur tendenca për të kaluar në një sistem miks, është shumë me rëndësi që të përcaktohen qartë termat, procedurat dhe praktikat se kur dhe si korrespondojnë në mes vete një procedurë penale dhe një procedurë civile e konfiskimit. Për më tepër, është e nevojshme që të definohen mirë edhe indiciet apo “red flags” të politikës së konfiskimit mbi bazën civile, në mënyrë që të ketë një bilanc të definuar mirë në mes të respektimit të të drejtave të njeriut, përkatësisht privatësisë dhe të drejtës së prokurorit për të nisur një procedurë hetimore. Më konkretisht duhet të definohen mirë se cilët janë faktorët që mund të nxisin një prokuror për të ndërmarrë një procedurë hetimi me karakter civil. Sistemi i deklarimit të pasurisë për shembull, mund të jetë një nga indikatorët kryesor mbi bazën e së cilit, një prokuror mund të bëjë hulumtime preliminare dhe të nxjerrë indicie të qëndrueshme dhe të bazuara para se të zhvillojë një hetim të plotë civil për konfiskimin e pasurisë së kundërligjshme. Një tjetër element që duhet të karakterizojë procesin e hartimit të ligjit anti-mafia në Kosovë, është edhe diskursi logjik mbi natyrën që përmban ligji, përkatësisht debati në mes të nocionit **“pasuri e fituar me vepër penale”** apo **“pasuri e fituar në mënyrë joligjore”**. Natyrisht se nga këndvështrimi i procedurës mbi bazë penale, subjekti i konfiskimit është ai që ka kryer veprën penale, përkatësisht të cilit i konfiskohet pasuria e përfituar me vepër penale e përcaktuar mirë në Kodin Penal. Në një situatë kur përveç procedurës penale prezantohet edhe procedura civile, është me rëndësi që të shqyrtohet terminologjia dhe logjika përcaktuese e efektit të ligjit. Në një situatë të tillë, terminologjia është shumë e rëndësishme për shkak se tashmë nuk kemi të

bëjmë me një konfiskim të pasurisë së përfituar me vepër penale, por me konfiskim të pasurisë së pajustificueshme apo të përfituar në mënyrë joligjore. Sipas kësaj logjike, debati duhet të zë vend në mes termit “pasuri e pajustificueshme” dhe “pasuri e përfituar në mënyrë joligjore” për shkak se njëra anë, konkretisht pasuria e pajustificueshme paraqet tendencat e konfiskimit të çdo lloj pasurie për të cilën subjekti nuk ka dëshmi të prejardhjes, gjë që do të ishte mbase e tepërt në këtë situatë aktuale, por në anën tjetër, nocioni pasuri e përfituar në mënyrë joligjore, do të ishte gjithëpërfshirës dhe do të nënkuptonte në vetvete edhe bazën penale edhe atë civile të konfiskimit.



05

**REKOMANDIMET
THEMELORE**

Në kuadër të përpjekjeve tona për të kontribuar në një shoqëri demokratike, të sundimit të rendit dhe ligjit dhe të një qeverisje përgjegjëse dhe të përkushtuar në përmbushjen e mandatit institucional, ky hulumtim analitik, ka pasur për qëllim të studiojë modalitetet dhe të shtrojë për debat çështjen e konfiskimit të pasurisë, porë nga një perspektivë e re, përkatësisht nga nevoja për një ligj të ri me karakter të plotë anti-mafia. Nevoja për një pako të tillë është konfirmuar javë më parë edhe nga raportet negative të Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën, duke mbështetur argumentet e tyre pikërisht në mungesën e një qasje serioze në luftimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit. Si rrjedhojë, domosdoshmëria e një ligji të ri që synon të përmbushë të gjitha aspektet e pa funksionalizuara deri më tani, në mënyrë që lufta kundër krimit të organizuar dhe pasurisë së gjeneruar nga ai të marrë kuptim, tashmë nuk është më nivel synimi por një domosdoshmëri e imponuar për Republikën e Kosovës në rrugën e saj drejt integriteteve të mëtejme evropiane. Në kuadër të këtij hulumtimi, ka pasur tendenca për të matur shkallën e kënaqshmërisë së akterëve përgjegjës me zbatimin e legjislacionit në fuqi në fushën e konfiskimit të pasurisë. Po ashtu janë studiuar disa praktika rajonale dhe legjislacione gjegjëse të cilat kanë shërbyer si një bazë e mirë krahasimi sistemesh për të kuptuar modele të ndryshme të konfiskimit të pasurisë dhe për të përfytyruar më shumë opsione që do të mund të ishin të zbatueshme në Kosovë. Rrjedhimisht, pas një pune disamujore, Çohu! përmes këtij studimi/analize, ka përpiluar disa rekomandime për procesin e mëtutjeshëm të hartimit të politikës së konfiskimit të pasurisë dhe Ligjit Anti-Mafia në përgjithësi.

Rekomandimet:

- a) **Baza e Re Ligjore.** Me gjithë synimet për të kuptuar natyrën e legjislacionit aktual dhe mundësinë për adoptimin e tij dhe shqyrtimin e aspekteve të caktuara për të përmirësuar bazën ligjore, kjo tashmë është e pamjaftueshme dhe si rrjedhojë, nevoja për një bazë tërësisht të re ligjore që do të adresonte të gjitha çështjet e shtruara më sipër, është mëse e nevojshme. Megjithatë, kjo bazë e re ligjore duhet të përfshijë një proces të konsiderueshëm këshillimesh me akterë të interesuar në mënyrë që të reflektojë këtë kombinim perspektivash dhe të shërbejë si një mjet funksional, për dallim nga Ligji për Kompetencat e Zgjeruara, përmes së cilit edhe pas tre vitesh të miratimit, nuk është zgjidhur asnjë rast i vetëm i konfiskimit;
- b) **Kuptimi i Ligjit Anti-mafia.** Ligji i ri, në mënyrë që të ketë karakter anti-mafia, siç pretendohet nga Ministria e Drejtësisë, duhet të përfshijë domosdoshmërisht diskutet siç janë përmendur edhe në këtë punim, dhe ku përfshihen: barra e provës, procedura civile, retroaktiviteti, njohja e instrumenteve juridike të ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit, etj. Vetëm me përfshirjen e këtyre elementeve, mund të konsiderohet se ky ligj do të shërbejë për qëllimin e konfiskimit të pasurisë dhe do të arrijë efekte të tilla që i përgjigjen objektivave të politikës së konfiskimit në përgjithësi;

“

Ligji i ri, në mënyrë që të ketë karakter anti-mafia, siç pretendohet nga Ministria e Drejtësisë, duhet të përfshijë domosdoshmërisht diskutet siç janë përmendur edhe në këtë punim, dhe ku përfshihen: barra e provës, procedura civile, retroaktiviteti, njohja e instrumenteve juridike të ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit, etj.

- c) **Barra e Provës.** Meqenëse është diskutuar edhe më lartë, rekomandimi ynë është që barra e provës të jetë subjekt diskutimi të gjërë, dhe që të arrijë në atë baraspeshë e cila në njërin anë e obligon subjektin e hetimit të ofrojë prova dhe dëshmi për prejardhjen e pasurisë së tij, ndërsa në anën tjetër, të sigurohet që me rastin e hetimit, organi hetues të reflektojë objektivitet që korrespondon me rrethanat e përgjithshme në Kosovë dhe që rrjedhimisht të respektohet e drejta e privatësisë dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi;
- d) **Retroaktiviteti.** Në mënyrë që ligji të marrë karakter anti-mafia, një nga çështjet bazë që ai duhet të përmbajë është retroaktiviteti. Koha kur retroaktiviteti do të duhej të hynte në fuqi sipas mendimit tonë është nga muaji janar i vitit 2000. Po ashtu, për të forcuar retroaktivitetin si entitet, do të duhej që me ligj të evitohet mundësia e parashkrimit të lëndëve që lidhen me pasurinë dhe konfiskimin e saj;
- e) **Struktura e implementimit.** Gjatë vizitave në terren kemi ardhur në përfundim se në një rrethanë të tillë që nënkupton sjelljen e një ligji të ri në të cilin përfshihet edhe konfiskimi me bazë civile, atëherë paralelisht me këtë është mëse e nevojshme që të ngritën kapacitetet profesionale të akterëve institucionalë që janë përgjegjës për implementimin e tij. Si rrjedhojë, është e rekomandueshme që për zbatimin e ligjit anti-mafia, të ndërtohen ekipe të veçanta prokurorësh, hetuesish madje edhe gjykatësish, të cilët do të merren ekskluzivisht me zbatimin e tij;
- f) **Instrumentet juridike.** Baza ligjore aktuale është e pa unifikuar në aspektin e njohjes së entiteteve dhe instrumenteve juridike të politikës së konfiskimit të pasurisë. Për këtë shkak, në ligjin e ri është e nevojshme që të specifikohen në mënyrë të hollësishme të tri instrumentet juridike, përkatësisht: ***ngrirja, sekuestrimi dhe konfiskimi;***

